VENDIM
Nr. 174, datë 3.8.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "OSOJA ENERGY" SHPK, NR. 408, SERIA P18K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 113, DATË 14.5.2018, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "SEMAN 1" ME VENDNDODHJE, SHEQ MARINAS, TOPOJË, FIER, ME FUQI 2 mw, PËR NJË AFAT 20-VJEÇAR, NË FAVOR TË SHOQËRISË "SEMAN 1 SOLAR" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 10, pika 1; nenit 17, pikat 1 dhe 4; të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s*", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96 datë 17.6.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., nr. 408, seria P18K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 113, datë 14.5.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Seman 1" me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier, me fuqi 2 mw, për një afat 20-vjeçar, te shoqëria "Seman 1 Solar" sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 413 prot., datë 24.5.2018, shoqëria "OSOJA ENERGY" sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së kësaj shoqërie, me nr. 408, seria P18K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 113, datë 14.5.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Seman 1" me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier, me fuqi 2 mw, për një afat 20-vjeçar, te shoqëria "Seman 1 Solar" sh.p.k.,

- Shoqëria "OSOJA ENERGY" sh.p.k., ka marrë miratimin nga MIE, me nr. 3245/1 prot., datë 20.4.2018 "Miratimi i transferimit të të drejtave", për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve që disponon në respekt të miratimit përfundimtar nr. 3887/2 prot., 23.12.2017 dhe kontratës së lidhur me MIE-në, nr. 1163 rep. dhe nr. 376 kol., datë 29.12.2017, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik "Seman - 1" me kapacitet instaluar 2 mw", në zonën Sheq Marinas – Topojë Fier në favor të shoqërisë Seman 1 Solar" sh.p.k.

- Në mbledhjen e Bordit, të datës 25.6.2018, në të cilën u relatua relacioni nr. 54/6 prot., datë 14.6.2018, "Mbi fillimin e procedurës për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., nr. 408, seria P18 K dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 113, datë 14.5.2018, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Seman 1" me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier, me fuqi 2 mw, për një afat 20-vjeçar dhe kalimin e saj në favor të shoqërisë "Seman 1 Solar" sh.p.k., nga Bordi i ERE-s u la detyrë kryerja e disa saktësimeve nga ana e aplikuesit.

- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 413/1 prot., datë 28.6.2018, iu drejtua subjektit "Osoja Energy" sh.p.k. duke i kërkuar:

- Formatin e aplikimit të plotësuar sipas nenit 9 pika 1 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*";

- Vërtetimin e organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për transferimin e licencës, sipas nenit 17, pika 4, germa "c" të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*";

- Saktësime në lidhje me pagesën e kryer për aplikimin, sipas nenit 8 pika 2 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*";

- Subjekti me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 413/2 prot., datë 16.7.2018 ka përcjellë

dokumentacionin e kërkuar më sipër dhe ka dhënë sqarimet përkatëse në lidhje me kryerjen e pagesës së aplikimit.

Aplikimi i shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*", si më poshtë:

- Neni 8 pika 2;
- Neni 9, pika 1;
- Neni 17, pika 1;
- Neni 17, pika 4.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës së shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k., nr. 408, seria P18K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 113, datë 14.5.2018, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Seman 1" me vendndodhje, Sheq Marinas, Topojë, Fier, me fuqi 2 mw, për një afat 20-vjeçar, te shoqëria "Seman 1 Solar" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti